

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
zgjidhjet**

P10

Data 05/12/2020

Detyra 1

Beni sapo është emëruar partner në firmën e auditimit Rama&Co. Beni është mik i mirë me partnerin menaxhues Arlind Rama për shumë vite. Më herët Beni kishte punuar si menaxher i trajnimit brenda firmës dhe tani është promovuar në partner të trajnimit. Kjo është hera e parë që firma e auditimit ka caktuar një partner për përgjegjësinë e trajnimit të personelit brenda firmës.

Si pjesë e zhvillimit profesional, personeli pritët të mbajë një 'ditar të trajnimit' në të cilin listohen punët e kryera. Ky ditar duhet të rishikohet nga Beni në baza periodike. Gjatë rishikimit të fundit, njëri nga personeli Flutura D., ka shënuar në ditar se ishte e shqetësuar me diçka që kishte ndodhur gjatë auditimit të kompanisë Shok Shpk, një kompani e mesme e menaxhuar nga familja që ishte klient i vjetër i Rama&Co.

Flutura ishte duke audituar blerjet e pasurive joqarkulluese kur vërejti një transaksion që mendoj se ishte i dyshimt. Ishte një shpenzim prej €175,000 (shumë individuale materiale) për një sistem të sofistikuar të teknologjisë informative të vendosur në një zonë rurale që nuk kishte fare lidhje me kompaninë. Kur e pyeti drejtorin financiar të Shok Shpk lidhur me këtë transaksion, ai i shpjegoi se kjo ka të bëjë me pajisje të telekonferencës të instaluar në shtëpinë verore (vilën) të drejtorit ekzekutiv e cila do të përdorej për komunikim me kompaninë kur ai ishte në pushime me familje. Drejtori financiar më tutje shpjegoi se kompania po ashtu paguan edhe koston e internetit të shpejtë për këtë sistem për të mundësuar lidhje të mirë pasi që shtëpia gjindej në një zonë ku nuk kishte kablo të internetit.

Drejtori financiar dukej i befasuar bile edhe i zemëruar nga pyetja që kishte bërë Flutura dhe tha se auditorët më parë nuk kishin bërë pyetje për pasuritë joqarkulluese dhe shpenzimet operative në pronën e drejtorit ekzekutiv.

Partneri i angazhimit në auditimin e Rama&Co është vet partneri menaxhues i firmës Arlind Rama. Flutura e kishte informuar Arlindin për ngjarjen dhe ai i kishte thënë që kjo çështje mund të injorohet. Mirëpo ai tha se do ta përfshinte çështjen në letrën e përfaqësimit sipas SNA 580 duke shtuar me buzëqeshje se "letra duron gjithçka". Pas rreth dy muajsh, Flutura e shikoi dosjen e përfunduar të auditimit dhe nuk pa ndonjë referencë për çështjen e ngritur. Kur ajo e pyeti Arlindin, ai tha "Oh e nderuar, si duket kam harruar, më fal. Më duhet ta bëjë shprehi që të marr shënime, mirëpo tash nuk kemi çfarë të bëjmë, auditimi ka përfunduar dhe natyrisht çdo gjë është mirë, kur përfundon mirë!"

Kur Beni i lexoi shqetësimet e Fluturës dhe pasi që bisedoi direkt me të, ai e kuptoi se këtu ka të bënte me një çështje etike. Së paku transaksioni do të duhej të shpalosej si transaksion me palë të lidhura sipas SNK 24 Shpalosjet e Palëve të Lidhura por situata ishte bërë më e komplikuar nga fakti që Arlind Rama është në një formë ende shef i Benit në firmë.

Kërkohet:

Draftoni një letër për Benin në të cilën:

- a) Diskutoni kuptimin e 'integritetit' dhe rëndësinë e marrëdhënieve profesionale siç janë ato të përshkruara në skenarin e mësipërm. (4 pikë)
- b) Kritikoni sjelljen etike dhe profesionale të Arlind Ramës. (9 pikë)
- c) Vlerësoni në mënyrë kritike alternativat në dispozicion për Benin lidhur me dilemën e tij etike. (9 pikë)

(Formati dhe prezantimi i përgjigjes 3 pikë)

(Total = 25 Pikë)

Zgjidhja

I nderuar

Ju falemnderit që më takuat javën e kaluar. Dua të shfrytëzoj rastin të shpjegojë pikët me të rëndësishme të diktimit tonë.

Siç u diskutuan më lart, do të adresojë secilën çështje me rradhë:

Kuptimi i 'integritetit' dhe rëndësia në marrëdhëniet profesionale

Analiza e sjelljes etike dhe profesionale në këtë rast (bazuar ekskluzivisht në informata që mi keni ofruar)

(a)

Integriteti

Kodi i etikës së FNK thotë se "Parimi i integritetit imponon një obligim te të gjithë profesionistët e kontabilitetit të jenë të drejtpërdrejt dhe të ndershëm në të gjitha marrëdhëniet e tyre profesionale dhe biznesore. Integriteti gjithashtu nënkupton marrëdhënie të drejta dhe të sinqerta".

Prandaj integriteti është obligim për të kryer punët drejt pavarësisht nga presioni ose nxitja për të bërë të kundërtën. Të vepruarit me integritet nënkupton një pozitë etike që është konsistente me standardet më të larta të profesionalizimit.

Integriteti është vital në marrëdhëniet profesionale sepse:

I ofron siguri kolegëve për qëllimet e mira dhe të sinqerta. Kjo shkon përtej çdo kodi të sjelljes profesionale dhe shpjegon një set të karaktereve të personit me integritet që do të thotë se është i besueshëm. Në këtë rast nga Arlindi kërkohet të bëjë më të mirën për klientin e tij, për partnerët dhe për stafin. Konfliktet natyrisht se do të paraqiten por duhet të trajtohen në mënyrën më të sinqert dhe të drejtpërdrejt. Nga ajo që u tha më lart, duket se arlindi nuk është duke u sjellur në këtë mënyrë me Fluturën kur ajo ngriti çështjet e lartveçura.

Koha dhe energjia në monitorim mund të zvogëlohet kur supozohet se në firmë ka sjellje me integritet. Arlindi është partner menaxhues dhe nëse nuk mund ti besohet, kjo e dëmton mjedisin e kontrollit të firmës së auditimit.

(b)

Çështja e parë që vërehet tek sjellja e Arlindit në këtë rast është se ai jep përshtypjen e joprofesionalizmit dhe madje edhe të korrupsionit. Shuma prej €175,000 është materiale, por përveç kësaj, alokimi i fondeve të kompanisë në diçka që konsiderohet lodër e shrenjtë për fëmijët e drejtorit ekzekutiv është dicka që duhet të sfidohet nga auditori.

Dështimi i Arlindit të veprojë mbi informatën e pranura sugjeron se ia ka dështuar në detyrën e tij kundrejt shfrytëzuesve të pasqyrave financiare të kompanisë, përfshirë huadhënësit e madje edhe autoritetet tatimore. Arlindi mund të mos e ndjejë detyrën për kujdes të duhur, mirëpo ai nuk do të duhej të nënshkruante raportin e auditimit nëse pasqyrat financiare nuk japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë.

Arlindi i kishte premtuar Fluturës se së paku do ta adresonte çështjen në letrën e përfaqësimit – dhe duket se e kishte nënvlerësuar rëndësinë e kësaj çështje.

Prandaj Arlindi paraqitet si person me mungesë të objektivitetit që duket si kërcënim i pavarësisë së tij ndaj klientit.

Kjo po ashtu tregon mungesë të respektit për profesionalizmin e Fluturës dhe mund të çoj Fluturën në sjelljen “pse të mërzhitem unë, kur nuk mërzhitet partneri”. Kjo do ta orientoj Fluturën në sjellje të dobët profesionale ose do të dëhspërohej nga firma dhe do të kërkonte punësim diku tjetër.

Arlindi është bashkëpjesëmarrës në shkeljen e mundshme të SNK 24 mbi transaksionet e palëve të lidhura. Ekziston kërkesa për shpalosje për të gjitha palët e lidhura pavarësisht shumë dhe fshehja e kësaj është edhe joprofesionale dhe teknikisht e parregullt. Mungesa e një shpalosje të tillë do të shkaktonte modifikimin e opinionit.

(c)

Ju mund të përpiqeni të zgjidhni dilemën etike në dy mënyra:

- Konfrontohu direkt me Arlindin për të parë nëse çështja mund të zgjidhet në mënyrë profesionale. Nëse Arlindi nuk i përgjigjet kësaj, ju duhet që dërgoni çështjen në nivele më të larta të firmës. Një mënyrë është të bisedohet me partnerët tjerë.
- Të mos ndërmerrni asgjë dhe ta leni çështjen ashtu siç është.

Vlerësimi që duhet ta bëni është duke iu referuar katër çështjeve të mëposhtme para se të zgjidhni cilin drejtim ta ndiqni.

Të gjithë kontabilsitetë profesionist kërkohej të jenë në pajtueshmëri me standardet më të larta etike dhe profesionale.

Pozita juaj si menaxher i trajnimit, partner dhe kontabilist profesionist.

Vendimi juaj do të ishte sinjal i rëndësishëm për Fluturën lidhur me pranueshmërinë e sjelljes së Arlindit në situata profesionale dhe në rëndësinë që vendoset kur ka ankesa nga personeli junior i firmës. Duke supozuar se keni identifikuar këtë çështje si mopajtueshmëri, do të ishte neglizhencë profesionale nga ana juaj nëse e injoroni atë.

Konfrontimi me Arlindin do të komprometonte miqësinë tuaj dhe marrëdhënien profesionale në të ardhmen. Gjithashtu do të ketë ndikim në karrierën tuaj profesionale.

Është me rëndësi të zhvillohet një marrëdhënie e mirë profesionale në situata të tilla sa më shumë që është e mundur. Lajmëtarët, qofshin të brendshëm ose të jashtëm zakonisht ballafaqohen me stres.

Është shumë me rëndësi të përcaktoni se si do ta çoj më tutje Flutura këtë çështje. Ndoshta konfrontimi me Arlindin nga ana juaj do të ishte opsioni më i mirë, pasi që do të zvogëlohej rreziku se Flutura mund të paraqes këtë rast në instance më të larta dhe në këtë mënyrë do të komprometonte edhe juve edhe Arlindin.

Edhe pse ka dy alternativa teorike në këtë dilemë, në opinionin tim, veprimi juaj i ardhshëm është i qartë. Ju duhet të konfrontoheni me Arlindin dhe të ndiqni cilin do veprim që siguron zgjidhje të kënaqshme të situatës.

Sinqerisht i juaji

Detyra 2

Ju jeni menaxher në Ingo, një firmë e auditimit. Ju keni përgjegjësi specifike për cilësinë e auditimit. Ingo është caktuar auditor i Argjenta shpk në janar të vitit 2020. Argjenta është një kompani ofruese e menaxhimit të mbeturinave. Ju sapo keni vizituar ekipin e auditimit në kompaninë Argjenta. Ekipi i auditimit përbëhet nga një auditor përgjegjës (AP), një senior i auditimit dhe dy staf të rinj që trajnohen.

Pasqyrat financiare draft të Argjenta shpk për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 paraqesin të hyra prej €11.6 milion (2018 – €8.1 milion) dhe pasuri totale prej €3.6 milion (2018 - €2.5 milion). Gjatë vizitës tuaj, rishikimi i letrave të punës ka zbuluar si në vijim:

(a) Në njërën nga listat kontrolluese të planifikimit të auditimit, seniori i auditimit ka shënuar tek procedurat analitike ‘nuk janë të aplikueshme – klient i ri’. Lista kontrolluese e planifikimit të auditimit nuk është nënshkruar si e rishikuar. **(5 pikë)**

(b) Auditori përgjegjës herën e fundit e kishte vizituar Argjenta shpk para dy javësh në janar 2020 në kohën kur kishte filluar auditimi. Që nga ajo kohë seniori i auditimit kishte përfunduar auditimin e pasurive jo-qarkulluese (përfshirë pronën dhe pajisjet) të cilat kishin shumën prej €0.6 milion me 31 dhjetor 2019 (2018 – €0.6 milion). AP kalon pjesën më të madhe të kohës duke punuar nga zyrat e Ingo dhe aktualisht është duke mbikqyrur edhe tre angazhime tjera përveç auditimit të Argjenta. **(5 pikë)**

(c) Me 31 dhjetor 2019 llogaritë e arkëtueshme kishin shumën prej €2.1 milion (2018 - €0.9 milion). Njëri nga stafi i ri sapo kishte përfunduar dërgimin e kërkesave të para për konfirmim direkt të salodove të llogarive nga konsumatorër për periudhën që auditohet. **(5 pikë)**

(d) Stafi tjetër është caktuar të auditojë furnizimet që përbëhen nga stoqet në vlerë prej €88,000 (2018 – €53,000). Stafi kishte kryer teste të kontrollit për regjistrat e sistemit të vazhdueshëm të stoqeve dhe ka konfirmuar një mostër të stoqeve duke u nisur nga stoqet e tanishme dhe duke mbledhur dhe zbritur shumat e blerjeve dhe shitjeve gjatë periudhës pas fundit të vitit për të arritur në saldon e 31 dhjetorit. **(4 pikë)**

(e) Auditori përgjegjës ka shënuar çështjen në vijim për t’u konsideruar nga ju. Pasqyrat financiare me 31 dhjetor 2018 kanë shpalosur një detyrim kontingjent të pa-kuantifikueshëm për një padi pezull. Megjithatë, AP e ka parë një letër që konfirmon se çështja është zgjidhur jashtë gjykatës për €0.45 milion me 14 mars 2019. Raporti i auditorit të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018 nuk ishte modifikuar dhe ishte nënshkruar me 19 mars 2019. AP beson se menaxhmenti i Argjenta nuk është në dijeni për gabimin dhe nuk ishte informuar. **(6 pikë)**

Kërkohet:

Identifikoni dhe komentoni mbi implikimet e këtyre gjetjeve për politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë së Ingo.

(Total = 25 Pikë)

Zgjidhja

(a) Procedurat analitike

Procedurat analitike mund të përdoren në të gjitha fazat e auditimit, por SNA 520 *Procedurat analitike* thekson se ato duhet të përdoren në fazën e planifikimit dhe të rishikimit. Në fazën e planifikimit, procedurat analitike janë mjet i dobishëm për t'i ndihmuar auditorit të identifikoj fusha me rrezik potencial të auditimit prandaj ndihmojnë në zgjedhjen e qasjes së auditimit.

Plani i auditimit duhet të përgatitet nga mbikqyrësi i auditimit dhe të rishikohet nga menaxheri i auditimit dhe partneri. Plani do të duhej të finalizohet para fillimit të auditimit. Fakti që auditori përgjegjës nuk e ka nënshkruar listën kontrolluese të auditimit tregon se memo të mos jetë e përfunduar. Kjo do të thotë se plani i auditimit nuk është i mjaftueshëm për të siguruar se auditimi ka përfunduar në mënyrë adekuate dhe kompetente.

(b) Rishikimi i auditorit përgjegjës

Seniori i auditimit duket se është angazhuar në fushën me rrezik më të ulët – pasuritë jo-qarkulluese të cilat përbëjnë 17% të pasurive gjithsej. Puna e auditimit në llogaritë e arkëtueshmenë anën tjetër iu ka dhënë një stafi junior që trajnohet. Kjo fushë ka rrezik më të madh pasi që përbën 58% të pasurive gjithsej. Dhe është dyfishuar nga viti i kaluar.

Plani duket se ka mangësi të mëdha që do të rezultoj me kualitet të dobët për shkak të auditimit neglizhent. Nënkuptohet që partneri nuk e ka rishikuar planin e që është detyrë e tij/saj sipas standardeve të auditimit.

Po ashtu është e dyshimt nëse auditimi është duke u mbikqyrur si duhet pasi që auditori përgjegjës është duke punuar në tre angazhime në kohën e njëjtë dhe nuk është e qartë nëse i dedikohet kohë e mjaftueshme për të audituar Argjentën.

(c) Llogaritë e arkëtueshme

Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme është metodë e zakonshme e përdorur për të përfutur dëshmi për shumat që kanë mbetur borxh në fund të vitit të një mostre të të arkëtueshmeve. Mirëpo, pasi që kanë kaluar disa javë pas fundit të vitit dhe do të kalon ca kohë për të marrë përgjigjet e konsumatorëve, ekipi duhet të konsideroj nëse kjo procedurë do të ofroj dëshmi të një saldoje materiale, dëshmi që mund të merret me verifikimin e pagesave pas datës së bilancit të gjendjes.

Duket se puna e juniorëve nuk është duke u mbikqyrur si duhet.

(d) Stoqet

Stoqet përbëhen nga një saldo jo-materiale në pasqyrat financiare të Argjenta (2.4% të pasurive totale). Qasja e auditimit që përdoret në këtë rast nuk është e përshtatshme pasi që është saldo e ulët dhe jo materiale.

Planifikimi i mjaftueshëm, përfshirë procedurat analitike paraprahe, do të identifikonte qasje shumë më të përshtatshme për këtë saldo të llogarisë. Poashtu edhe rishikimi i duhur i stafit junior nga auditori përgjegjës në bazë të vazhdueshme do të identifikonte fusha me interes.

(e) Ngjarjet pas datës së raportimit

Kjo është një ngjarje materiale pas datës së raportimit (zgjidhja e çështjes gjyqësore) që ka ndodhur para nënshkrimit të raportit të auditimit të vitit të kaluar dhe një ngjarje e tillë nuk ishte vërejtur vitin e kaluar. Kjo është çështje e cilësisë së auditimit dhe sugjeron se dikush nuk e ka kryer procedurën e auditimit lidhur me ngjarjet pas datës së pasqyrave financiare siç kërkohet me SNA 560 *Ngjarjet pasuese* para se të nënshkruhet raporti i auditimit. Në mënyrë alternative kjo procedurë është kryer si duhet mirëpo menaxhmenti me qëllim ose gabimisht ka dhënë informata të gabuara stafit të auditimit dhe për këtë qëllim nuk ishte përmendur në letrën e përfaqësimit të menaxhmentit.

Pasi që kjo çështje është materiale për pasqyrat financiare, ky gabim kërkon korrigjim në pasqyrat financiare të vitit aktual në pajtueshmëri me SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Auditori përgjegjës duhet të kërkoj nga klienti të korrigjohen pasqyrat financiare.

Nëse menaxhmenti dështon të korrigjoj pasqyrat financiare dhe çështja është materiale, kjo do të rezultonte në modifikim të opinionit për vitin 2015 sepse provizioni është dashur të njihet vitin e kaluar prandaj pasqyra e të ardhurave e vitit aktual nuk është e saktë.

Nëse kjo çështje është përfshirë në letrën e përfaqësimit vitin e kaluar dhe nuk ishte e saktë, auditorët duhet të konsiderojnë efektin që ka kjo në cilësinë e përfaqësimeve të bëra nga menaxhmenti në vitin aktual dhe duhet të konsideroj nëse kjo do të thotë se ka dëshmi të pamajftueshme për shifrat e vitit të kaluar që do të shkaktonte të kryhet më shumë punë për të aritur të shifrat e sakta krahasuese ose të modifikohet opinion sa i përket shifrave krahasuese.

Kjo situatë ka mundësi të rezultoj me punë shtesë prandaj është e mundur që partneri i angazhimit duhet të alokoj personel shtesë për të kryer auditimin e vitit 2019.

Në fund, partneri i auditimit duhet të siguroj se auditimi i vitit 2019 të kryhet në mënyrë më efektive. Vëmendje e veçantë duhet të vihet te përfaqësimet e menaxhmentit dhe rishikimit të ngjarjeve pasuese.

Detyra 3

(a) Përkufizoni 'pastrimin e parasë' dhe përshkruani procedurat që janë specifike për pastrimin e parasë që duhet të konsiderohen para dhe gjatë pranimit të angazhimit për auditim.

(5 pikë)

(b) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën e auditimit Kon-Aud. Klienti juaj i auditimit, Mali shpk, dizajnon dhe prodhon tavolina dhe karriga të metalit. Biznesi është rritur shumë në dy vitet e fundit, pas arritjes së Arben Ceku, një menaxher i shitjes dhe marketingut me përvojë. Drejtorët duhet të sigurojnë një kredi në vlerë prej €3 milion për të zgjeruar aktivitetet e kompanisë, pas dizajnit të një game plotësisht të re të mobileve të metalit për kopësht. Drejtorët kanë biseduar me bankën GUK Bank për këtë kredi. Kriteri kryesor i bankës deklaron siç vijon: 'Aplikacionet për kredi duhet të shoqërohen me planin e detajuar të biznesit, përfshirë një analizë se si do të përdoret financimi. GUK Bank duhet të vërtetohet se financimi i kërkuar është i mjaftueshëm për qëllimin e propozuar të biznesit. Plani i biznesit duhet të jetë i mbështetur nga opinioni i auditimit për mjaftueshmërinë e financimit të kërkuar.'

Financimi prej €3 milion do të përdoret siç vijon:

Ndërtimi i fabrikës së re	1,250,000
Blerja e makinerisë së re	1,000,000
Furnizimi fillestar i lëndës së parë	250,000
Reklama dhe marketingu i produktit të ri	500,000

Firma e juaj është pajtuar të rishikojë planin e biznesit dhe të ofrojë një raport mbi plotësinë e kërkesës për financim. Takimi do të mbahet nesër me klientin për ta diskutuar këtë angazhim.

Kërkohet:

(i) Identifikoni së qafarë lloji i angazhimit për siguri është ky dhe shpjegoni çështjet që lidhen me këtë angazhim për siguri e cila duhet të diskutohet nesër në takim me Mali Shpk.

(8 pikë)

(ii) Theksoni pyetjet që duhet të bëni në bisedë me drejtorët e Mali Shpk për tu siguruar për mjaftueshmërinë e kërkesës për financim prej €3 milion për linjën e re të prodhimit.

(7 pikë)

Gjatë vitit auditori i brendshëm i Mali Shpk ka zbuluar disa mospërputhje në regjistrat e stokeve. Në deklaratën e bërë për bodrin e drejtorëve, auditori i brendshëm tha:

'Mendoj se dikush është duke marr artikuj nga stoqet e depos. Numërimi fizik kryhet çdo tre muaj, dhe është e qartë se rreth 200 kuti me karrige dhe tavolina të paketuara janë duke u zhdukur çdo muaj. Na duhet të angazhojmë dikë për të hetuar çka po ndodhë dhe të vlerësojë vlerën e humbjes'.

Kërkohet:

(c) Shpjegoni përgjegjësitë e auditorëve për sa i takon mashtrimeve dhe gabimeve. (5 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhja

(a) – Pastrimi i parasë është proces përmes të cilit kriminelët tentojnë të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e parave të gjeneruara nga aktivitetet kriminale, duke i lejuar atyre të mbajnë kontrollin mbi ato para dhe në fund të ofrojnë një mbulësë legjitime për burimin e të hyrave. Qëllimi i pastrimit të parasë është thyhet lidhja në mes të parasë dhe krimit nga i cili ka rezultuar.

Procedurat përfshijnë:

– Identifikimi i klientit

- Përcaktimi i identitetit dhe aktivitetit të biznesit, psh duke përfshirë pasaportën, adresën, certifikatën e biznesit.
- Konsiderimi nëse aktiviteti komercial ka kuptim biznesor (pra nuk është vetëm ‘fytyra’ e një aktiviteti joligjor)
- Përcaktimi i listës së aksionarëve kryesor dhe drejtorëve.

– Njohja me klientin:

- Komunikimi para angazhimit për të shpjeguar pronarit dhe drejtorëve të tjerë për natyrë dhe arsyet e procedurave të pranimit të angazhimit.
- Praktikë më të mira rekomandojnë se letra e angazhimit duhet të përfshijë paragraf në të cilët përshkruhet përgjegjësia e auditorit lidhur me pastrimin e parasë.

(b)

(i) Ky angazhim ka gjasë të madhe të jetë angazhim për siguri sipas *Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISAE 33400 Ekzaminimi i informatave të ardhshme financiare* që ofron siguri të kufizuar mbi qështjet që raportohet. Ky angazhim nuk do të jetë auditim I pasqyrave financiare apo I parashikimit të parasë pasi që kemi të bëjmë me informata të ardhshme financiare.

Çështjet që do të diskutohen mund të përfshijnë si vijon:

Përmbajtja e saktë e planit të biznesit e cila mund të përfshijë:

- Përshkrimin e performancës së kaluar dhe produktet kyçe
- Diskutimi i produktit të ri
- Dëshmi të aftësisë për tu shitur produkti i ri
- Parashikimet e rrjedhës së parasë
- Supozimet kyçe të biznesit
- Parashikimet për shpenzime kapitale

Forma e raportit të auditimit që kërkohet duhet të diskutohet

Për kufizimin e përgjegjësisë profesionale, duhet të qartësohemi me bankën në mënyrë që të sigurohemi se banka është pranuesi i vetëm i raportit dhe se opinion do të përdoret vetë për vendimet e bankës. Sa i përket kufizimit të përgjegjësisë, firma e auditimit do të donte të pranonte një deklaratë të shkruar në të cilin thuhet se raporti është për qëllime të informimit dhe nuk paraqet ndonjë përgjegjësi, detyrim ose ndonjë detyrë tjetër nga firma për huadhënësin. Duhet të diskutohen afatet kohore kur i nevojitet raporti bankës. Kjo do të ndikohet nga koha se kur i nevojitet financimi kompanisë. Banka mund të kërkojë një kohë të konsiderueshme për ta vlerësuar aplikacionin për kredi, të rishikojë raportin dhe të sigurojë se janë duke u përmbushur kriteret e dhënies së kredisë.

Disponueshmëria e dëshimive – kompania duhet të jetë e ndërgjegjshme se në mënyrë që auditori të jep një opinion, ata duhet të ofrojnë dëshmitë e kërkuara në formë të dokumenteve. Dëshmia ka mundësi të përfshijë diskutimet me menaxhmentin kyç dhe përfaqësimet e shkruara.

Rregulloret profesionale – firma e auditimit duhet të diskutojë llojet e procedurave të cilat duhet të ndërmerren, dhe të konfirmojë se ata do të jenë në pajtueshmëri me udhëzuesit profesional, psh Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISAE 33400 Ekzaminimi i informatave të ardhshme financiare, etj

Administrimi i angazhimit – çfardo pike e padiskutuar në detaje e që mund të jenë:

- Tarifat – ato duhet të pajtohen në fillim të angazhimit
- Personeli – firma e auditimit duhet të identifikojë personelin kyç i cili do të jetë i përfshirë në këtë angazhim
- Letra e angazhimit – nëse nuk është nënshkruar ende.

(ii) Është me rëndësi të vërehet se kërkesa për financim duhet të mbulojë jo vetëm koston e ndërtimit por gjithashtu kosto që nevojiten ta ndihmojnë njësinë biznesore të operojë, dhe para e mjaftueshme për të mbuluar kërkesat për capital qarkullues

Kompania mund të ketë para të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet shtesë, por banka kërkon që të sigurohet se ka mjete të mjaftueshme.

Bisedat/pyetjet me menaxhmentin mund të përfshijnë:

Kush e ka përgatitur parashikimin e parasë? Është me rëndësi të vlerësohet përvoja dhe kompetenca e personave që kanë përgatitur këtë parashikim. Nëse menaxhmenti ka përgatitur më parë parashikime dhe buxhete besueshme dhe të sakta, kjo do të shtonte nivelin e besueshmërisë edhe për përgatitjen e parashikimit në fjalë.

Deri në çfarë mase kompania ka në dispozicion financim të brendshëm për të mbuluar mungesën nga kërkesa për financim? Nëse ka para tepriçë brenda organizatës, atëherë banka mund të mos e jap tërë shumën e kërkuar nga kompania.

A është përfshirë kosto e financimit në parashikim? Duket se kostoja po mungon. Kosto e financimit duhet të llogaritet bazuar në normën e parashikuar të interest dhe të përfshihet në koston totale.

Cili është cikli i parashikuar operativ i njësisë së re biznesore? Në veçanti sa e gjatë është preiudha e punës në process dhe me çfarë kushte të pagesës do tu ofrohen produktet konsumatorëve? Mund të kërkohej më shumë capital fillestar për kapitalin qarkullues sidomos kur ndodhë puna në proces dhe para se të inkasohet paraja nga konsumatorët. A do të kërkohej lëndë e parë shtesë? Kërkesa është bërë për €250,000 të lëndës së parë. Mund të jetë e nevojshme të blihen materiale tjera gjithashtu.

Sa do të zgjasë lënda e parë? Sa do të zgjasë puna në process për produktin e ri? Ndoshta do të duhet financim shtesë për të shmangur mbetjen pa stoqe.

Ndërtimi i fabrikës së re – a ka dokumente për të mbështetur shpenzimet kapitale? Për shembull, planet e arkitektëve, raporte të vlerësuesve, etj. Kjo do të mbështet saktësinë e financimit të kërkuar dhe është dëshmi e rëndësishme duke pasur parasysh materialitetin e financimit të kërkuar.

A janë mbledhur ofertat për makinerinë që do të blihet?

Blerja e makinerisë së re – a do të ketë kosto specifike të instalimit dhe dërgesës

Buxheti duket se nuk ka përfshirë kërkesën për financim të shpenzimeve të përgjithshme siç janë energjia elektrike gjatë ndërtimit dhe marrja me qira e pajisjeve të ndërtimit. A janë përfshirë këto kosto në kosto të ndërtimit?

A duhet të trajnohet stafi në përdorimin e makinerisë së re? Nëse po, so do të jeto kjo kosto.

Reklama dhe marketingu i produktit të ri – pyetni se çfarë metoda do të përdoren në marketingun e produktit të ri.

Disa kosto të reklamës janë shumë të larta dhe kërkojnë para të mjaftueshme, si për shembull reklamat televizive.

Banka po ashtu do të vlerësojë aftësinë e pagesës së kredisë që do të thotë se dot ë analizojë potencialin e gjenerimit të parasë nga ana e linjës së re të prodhimit. Prandaj duhet të bëhen pyetje lidhur me mundësinë e suksesit të produktit të ri, për shembull:

- A është bërë ndonjë hulumtim i tregut për të mbështetur arsyeshmërinë komerciale të produktit të ri?
- A janë negociuar kontrata me shitësit me pakicë për produktet e reja?
- Sa shpejtë produktet e kaluara kanë gjeneruar para?
- A ka plan rezervë në rast se produktet e reja nuk janë të suksesshme?

(c) Përgjegjësia e auditorëve për sa i takon mashtrimeve dhe gabimeve

SNA / ISA 240 *Përgjegjësia e auditorëve për të marrë në konsideratë mashtrimet në një auditim të pasqyrave financiare* parashtrohet se përgjegjësia kryesore për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve mbetet me personat që përgjigjen për qeverisjen dhe me menaxhmentin e një entiteti. Parandalimi i mashtrimeve ose gabimeve, nuk është funksion i auditorit, megjithëse fakti që në entitet kryhen auditime mund të shërbejë si një frenues i fenomeneve.

Për sa i takon zbulimit, SNA / ISA 240 parashtrohet se auditori duhet të vlerësojë rrezikun e anomalive materiale që janë rrjedhojë e mashtrimeve si në nivel të pasqyrave financiare ashtu edhe në nivel të pohimeve dhe të përcaktojë masat e marra për të parandaluar rreziqet e vlerësuara. Diçka e tillë mund të përfshijë ndryshimin e natyrës, të kohës kur kryhen dhe të shtrirjes së procedurave të auditimit, për shembull mund të bëhen më shumë inspektime, mund të kryhet më shumë punë gjatë vitit në vend që të kryhet në fund të tij dhe të zgjidhen mostra më të mëdha.

Qasja ndaj gabimeve sipas SNA / ISA 315 *Njohja e entitetit dhe e mjedisit në të cilin vepron ai dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale* dhe SNA / ISA 330 *Procedurat e auditori si përgjigje të rreziqeve të vlerësuara* është kryesisht i njëjtë me qasjen e parashtruar më sipër për mashtrimet.

Në kushte praktike mundësia e zbulimit të gabimeve do të jetë shumë më e lartë se sa ai i zbulimit të mashtrimeve meqenëse normalisht, mashtrimet në vetvete përfshijnë edhe përpjekjet për t' i fshehur ato, përfshirë këtu marrëveshjet e fshehta midis punonjësve dhe falsifikimit të regjistrave.

Në secilin rast auditimi i nënshtrohet një rreziku të pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale do të mbeten pa u zbuluar.

Në qoftë se auditori identifikon një shembull të mashtrimeve ose gabimeve, ai duhet të dokumentojë gjetjet e tij dhe t' i raportojë ato tej niveli i përshtatshëm i menaxhmentit dhe nëse ka mundësi edhe tek personat përgjegjës për qeverisjen e entitetit varësisht nga rëndësia e tyre.

Në të njëjtën kohë, auditori duhet të marrë në konsideratë ndikimin e tyre të mundshëm mbi opinionin e auditimit. Në qoftë se mashtrimet ose gabimet kanë një efekt material mbi pasqyrat financiare, auditori mund të duhet modifikojë raportin e tij. Natyra e modifikimit do të varet nga rrethanat specifike.

Auditori mund të duhet të marrin në konsideratë faktin nëse ekziston një detyrim ligjor për të raportuar ndodhjen e mashtrimeve ose gabimeve materiale ndaj autoriteteve rregullative ose përmbartëse.

Detyra 4

(a) Udhëzimet për ngjarjet pasuese janë dhënë në SNA 560 (*i rishikuar*) Ngjarjet Pasuese.

Kërkohet:

Shpjegoni përgjegjësinë e auditorit lidhur me ngjarjet pasuese.

(5 pikë)

(b) Heri është një kompani automobilistike e listuar në bursë. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 paraqesin fitim para tatimit prej €5.4 milion dhe pasuri totale prej €20.8 milion. Ju jeni meanxher i auditimit dhe seniori ju ka ofruar informatat në vijim:

- (i) Gajtë vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2019 Heri ka shpenzuar €800,000 në hulumtimin e një motori efikas me djegie të brendshme. Si rezultat i këtij hulumtimi, Heri ka disenjuar një motor të ri dhe ka bërë një progres domethënës në zhvillimin e këtij motori. Gjatë vitit që përfundoi me 31 dhjetor 2019 janë shpenzuar € 1.5 milion në këtë projekt ('Shtytja e re'). Drejtorët e Heri kanë kapitalizuar koston prej €1.5 milion si pasuri të patrupëzuar.

(8 pikë)

- (ii) Me 30 nëntor 2018 Heri pranoi një lajmërim nga juristi i tyre lidhur me një pretendim ligjor nga konsumatorët për problemin që kishin pasur me sistemin e frenimit në automjetet e prodhuara nga Heri. Me 31 dhjetor 2018 nuk ishte e ditur as mundësia e ndodhjes së këtij pretendimi e as shuma nuk mund të përcaktohej dhe si rezultat i kësaj nuk ishte njohur ndonjë provision në pasqyrat financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018. Me 31 dhjetor 2019 rasti është ende në proces por tani juristi i kompanisë ka këshilluar Heri se shuma e pretendimit është vlerësuar në €2 milion dhe që pretenduesit kanë shumë mundësi të kenë sukses në gjykatë.

(7 pikë)

- (iii) Gajtë vitit është përcaktuar një skemë e opsioneve të aksioneve. Sipas skemës, të gjithë drejtorëve u janë dhënë opsione me 31 korrik 2019. Opsionet do të maturohen me 31 korrik 2022 me kusht që drejtorët të jenë ende të punësuar me atë datë.

(5 pikë)

Kërkohet:

Për secilën nga pikat e mësipërme:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen
(ii) Shpjegoni testet e auditimit të cilat duhet të kryhen para takimit tuaj me partnerin e auditimit javën që vjen.

Shënim. Supozoni se është data 11 shkurt 2020.

Total: 25 pikë

Zgjidhja

Ngjarjet pasuese definone si ngjarje që ndodhin në mes të datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të auditimit, dhe po ashtu faktet që janë zbuluar pas datës së raportit të auditimit.

SNA 560 *Ngjarjet pasuese* bëjnë dallimin në mes të përgjegjësi të auditorit lidhur me ngjarjet pasuese varësisht nga koha kur ndodhë një ngjarje pasuese.

Ngjarjet që ndodhin deri në datën e raportit të auditorit.

Auditori ka detyrë aktive për të kryer procedura të dizajnuara për të identifikuar dhe përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të gjitha ngjarjet deri në datën e raportit të auditorit të cilat ngjarje mund të kërkojnë korrigjim ose shpalosje në PF. Këto procedura duhet të kryhen sa më afër të jetë e mundshme datës së raportit të auditorit, dhe përveç kësaj duhet të kërkojnë përfaqësim nga menaxhmenti.

Procedurat mund të përfshijnë rishikimin e procedurave të menaxhmentit për të siguruar se ngjarjet pasuese janë identifikuar, leximi i procesverbaleve të takimeve të bordit, rishikimi i pasqyrave financiare të ndërmjetme, bisedat e duhura menaxhmentin.

Kur një ngjarje material pasuese është zbuluar, auditorit duhet të konsiderojë nëse menaxhmenti ka trajtuar si duhet dhe shpalosur si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 10 *Ngjarjet pas datës së raportimit*.

Faktet e zbuluara pas datës së raportit të auditorit por para datës së publikimit të PF.

Auditori nuk ka ndonjë përgjegjësi të kryej procedura ose ti parashtojë pyetje menaxhmentit sa i përket pasqyrave financiare ose ngjarjeve pasuese pas datës së raportit të auditimit. Në këtë periudhë, është përgjegjësi e menaxhmentit të informojë auditorin për faktet të cilat mund të ndikojnë në PF.

Kur auditori është në dijeni për faktet të cilat mund të ndikojnë materialisht PF, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Nëse PF janë ndryshura në mënyrë të duhur, atëherë duhet të jepet një opinion i ri i auditimit, dhe procedurat që kanë të bëjnë me ngjarjet pasuese duhet të shtrihen deri në datën e raportit të ri. Nëse menaxhmenti nuk i ndryshon PF për të reflektuar ngjarjen pasuese, në rrethana kur auditori beson se duhet të ndryshohet, duhet të jepet opinion me rezervë ose i kundërt.

Faktet e zbuluara pasi që pasqyrat financiare janë publikuar.

Pas publikimi të pasqyrave financiare, auditori nuk ka obligim të parashtojë pyetje lidhur me PF. Mirëpo, nëse auditori është në dijeni për ndonjë fakt që ka ekzistuar në datën e raportit të auditimit, që po të dihej në atë kohë do të shkaktonte modifikimin e raportit të auditorit. Në këtë rast, çështja duhet të diskutohet me menaxhmentin. Kjo mund të rezultojë me korrigjim të pasqyrave financiare, dhe në këtë rast auditori do të lëshonte raport të ri të auditimit për PF të korrigjuara. Ky raport do të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes që i referohet shënimit në PF në të cilin paraqiten arsyet e korrigjimit të PF. Nëse menaxhmenti refuzon të korrigjoj PF, auditori duhet të marrë këshilla ligjore me qëllim të përpjekjes për të parandaluar mbështetjen e mëtutjeshme të shfrytëzuesve të PF në raportin e auditimit.

(a) **Projekti Shtytja e Re**

(i) *Çështjet që duhet konsideruar*

- Nëse shpenzimet e ndodhura në projektin **Shtytja e Re** përmbushin kriteret siç specifikohen në SNK 38 për projektin që të kapitalizohet si kosto e zhvillimit
- Nëse shpenzimet e ndodhura janë €1.5 milion
- Nëse drejtorët kanë bërë shpalosjet e duhura në pajtueshmëri me SNK 38
- Kur do të hyjë në përdorim motori (dmth, a është edhe kjo kosto e zhvillimit)
- Cilat janë të hyrat e parashikuara nga motori
- Për çfarë periudhe do të jetë motori në treg

(ii) *Testet e auditimit*

- Përftoni detaje se si Heri i ka alokuar kostot në projekte individuale
- Rishikoni sistemin e alokimit të kostove në projekte
- Kontrolloni se ka kontrolle të mjaftueshme për të siguruar se vetëm kostot e identifikueshme janë alokuar në secilin projekt
- Përftoni një analizë të €1.5 milion dhe kontrolloni se kostot kanë të bëjnë me projektin
- Ndjekni materialet deri te faturat
- Ndjekni koston e punës deri tek lista e pagave
- Vërtetoni se si drejtorët alokojnë shpenzimet e përgjithshme dhe rishikoni metodën për arsyeshmëri
- Përftoni detaje të projektit dhe vërtetoni se është projekt qartë i identifikueshëm
- Përftoni detaje të rezultateve të provave deri me këtë datë dhe diskutoni me menaxherin e projektit për të konfirmuar arsyeshmërinë teknike të projektit
- Përftoni detaje të hulumtimit të tregut për të siguruar se projekti është i vlefshëm nga aspekti komercial
- Përftoni parashikimet për parane dhe vlerësoni supozimet për të testuar arsyeshmërinë nëse të hyrat e parase në të ardhmen do të tejkalojnë kostot deri me tani dhe kostot e ardhshme të marketingut
- Rishikoni parashikimet e shitjeve dhe përputhini me hulumtimet e tregut për të konfirmuar arsyeshmërinë
- Rishikoni nivelin e financimit të kërkuar për të përfunduar projektin dhe diskutoni me drejtorët se si ata kanë për qëllim të përmbushin nevojat për financim
- Rishikoni procesverbalet e takimeve të bordit për detajet ose diskutimet për progresin e projektit
- Përftoni përfaqësime të shkruara nga menaxhmenti lidhur me vlefshmërinë komerciale, arsyeshmërinë teknike dhe mjaftueshmërinë e financimit të projektit
- Konfirmoni me menaxhmentin se ata do të përmbushin kërkesat për shpalosje sipas SNK 38
- Rishikoni progresin e projektit në periudhën pas përfundimit të vitit dhe rishikoni detajet e ndonjë produkti të ngjashëm nga konkurrenca

(b) Çështja ligjore

(i) Çështjet që duhet konsideruar

- Nëse drejtorët kanë për qëllim të bëjnë ndonjë provision në PF për vitin që përfundon me 31 dhjetor
- Nëse është i mjaftueshëm provizioni prej €2.0 milion
- Bazën e llogaritjes së €2.0 milion
- Datën e mundshme të zgjidhjes
- Nëse duhet të shpaloen në mënyrë të veçantë €2 milion në pajtueshmëri me SNK 1 në PF.
- Nëse drejtorët do të bëjnë shpalosje të mjaftueshme në PF

(ii) Testet e auditimit

- Përftoni detaje të punës së kryer të auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor
- Përftimi i kopjeve të korrespondencave nga këshilltari ligjor lidhur me testet/provat dhe rishikimin e detajeve të mundësisë së ndodhjes si dhe llogaritjen e €2 milion.
- Diskutoni me drejtorët për reagimin e tyre lidhur me vlerësimin nga këshilltari ligjor
- Merrni leje nga drejtorët për të kontaktuar këshilltarin ligjor

- Kontaktoni këshilltarin ligjor dhe pyetni për konfirmimin e vlerësimit të tyre për ndodhjen dhe vlerën
- Rillogaritni llogaritjen e €2 milion
- Rishikoni periudhën e pas fundit të vitit për korrespondenca të mëtutjeshme lidhur me pretendimin
- Rishikoni periudhën e pas fundit të vitit për pagesa me para për tu siguruar nëse është bërë ndonjë zgjidhje e rastit jashtë gjykatës dhe krahasoni me shumën e paraqitura
- Rishikoni procesverbalet e takimeve të bordit për diskutimet e drejtorëve lidhur me pretendimin
- Diskutoni me menaxhmentin nëse ata kanë për qëllim të nohin ndonjë provision në PF e vitit
- Vërtetoni natyrën e shpalosjes që do ta bëjë menaxhmenti
- Konfirmoni se shpalosjet i përmbushin kërkesat e SNK 37 dhe SNK 1
- Diskutoni me menaxhmentin nëse ka ndonjë implikim për produktet e prodhura nga Heri
- Bëni rishikimin e periudhës pas fundit të vitit për të rishikuar të gjitha korrespondencat me këshilltarin ligjor për të verifikuar nëse a pasur pretendime tjera lidhur me produktet tjera

(c) **Skema e opsioneve të aksioneve**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- Nëse drejtorët kanë njohur shpenzimin për skemën në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- Kushtet e skemës, siç është numri i opsioneve që do të japin
- Nëse vlera e opsioneve është llogaritur duke përdorur metodën në pajtueshmëri me IFRS 2 *Pagesat e bazuara në aksione*
- Nëse janë azhurnuar supozimet për numrin e drejtorëve që do të kenë të drejtë të marrin opsionet
- Nëse detajet e skemës janë shpalosur si duhet në PF

(ii) *Testet e auditimit*

- Inspektoni dokumentimin e skemës për të verifikuar kushtet, numrin e opsioneve të ofruara, datat e ofrimit dhe datat e dhënies dhe kushtet e tyre
- Përfsoni llogaritjet e vlerës së drejtë të opsioneve dhe përputhni përbërësit e llogaritjes, siç është vlera e drejtë e aksioneve me informatat e publikuara nga tregjet financiare.
- Rillogaritni shpenzimet e vitit aktual, për të siguruar se vetëm shpenzimet e 6 muajve janë njohur
- Rishikoni regjistrimet në ditar për shpenzimin e opsioneve të aksioneve dhe kontrolloni se janë kredituar në ekuitet e jo në detyrime pasi që kjo është pagesë që bëhet përmes ekuitetit